

AKT THEMELIMI
ISHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"IDEAL Promo" shpk

Ne Tirane, sot me date **28 prill 2018**, (dymije e tetembedhete), ne te nenshkruarit e meposhtem :

EROLD BALLA, atesia Ferit, i datelindjes 22.03.1978, lindur ne Korce, banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID, me Nr. 027692793 dhe Nr. Personal H80322059L.

NENSI RISTANI, atesia Arben, e datelindjes 15.12.1995, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotësi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me leternjoftimin ID me Nr. 032541745 dhe me Nr. personal J56215066N.

*me cilesine e "Ortakeve Themelues", redaktojne kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklarojme se ne vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", me ndryshimet perkatese, ne ligjin "Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**IDEAL Promo**" shpk.*

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**IDEAL Promo**" shpk.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "**IDEAL-Promo**" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizikë te siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Selia ligjore e Shoqërisë ndodhet në adresën Tirane, "Rruga e Kosovareve", pall TID, kati 3, aptamenti 6, ne zonen kadastrale 8270, Pasuria 7/298+1-9, Volumi 34, faqe 170.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

E. Repa

N. Ristani

Objekti

Veprimtaria e Shoqërisë do të jetë kryerja e të gjitha aktiviteteve që mund të kryhen nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke përfshirë por pa u kufizuar në aktivitetet e mëposhtme:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- Projektimi, ndertimi i veprave civile, industriale, turistike, bujqesore, kompletimi dhe instalimet e nevojshme për to, punime restaurimi.
- Ndertime rrugore, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime hidroteknike (ujesjellesa, kanalizime, ndertime vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese, ndertime impiante të trajtimit të ujit, të trajtimit të mbeturinave, punime mbrojtëse dhe sistemimi hidraulik, punime montimi dhe teknologjike, punime topogjeodezike.
- Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndertimit.
- Prodhimin e materialeve inerte në përgjithësi, përpunimin dhe shitjen e tyre .
- Projektimin, ndertimin, ristrukturimin dhe modernizimin (përtëritjen) e objekteve civile, industriale, ndertimin dhe shtrimin e rrugëve në përgjithësi.
- Tregeti me pakice karburantesh, produkte të naftës dhe gazit natyror pëfshirë dhe bitum special
- Import dhe eksport projektimin ,ndertimin,magazinimin në territorin shqiptar dhe të huaj të një rrjeti të shpërndarjes të GPN (gaz ,produkte naftë) për përdorim shtëpiak dhe industrial me bombola,serbatore të vegjël dhe sistem tubash, lubrifikante dhe shërbime .
- Import-Eksport, tregtim me shumicë e pakice i të gjitha llojeve të mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, metale, duralumin, elektroshtepiake dhe të tjera ndertimore.
- Import-export i lëndës së parë që nuk prodhohet në vend dhe tregtimin si të produkteve të përpunuara, ashtu dhe prodhimet vendase, **te të gjitha llojeve dhe artikujve si me poshte, si me pakice ashtu edhe me shumice.**
- **Prodhim dhe tregtim**, artikuj të ndryshëm industrial dhe ushqimor.
- **Prodhim dhe tregtim**, artikuj të ndryshëm të fushës së bujqesive dhe të blektorise.
- **Prodhim dhe tregtim**, artikuj të ndryshëm konfensionesh, kerpi, lini, etj.
- **Prodhim dhe tregtim**, artikuj të ndryshëm detergjentesh, për larje rrobesh, për larje dhe mbetje yndyrnash, shampo të të gjitha llojeve e të tjera të kësaj natyre.
- **Prodhim dhe tregtim**, artikuj të fushës së kozmetikës & të estetikës;
- **Prodhim dhe tregtim**, lengje sapuni, sapuna të ngurta rrobesh dhe fytyrë, etj.
- **Prodhim dhe tregtim**, materiale plastike të llojeve dhe formave të ndryshme;
- **Prodhim dhe tregtime**, sende artizanale në fushën e qeramikes dhe të porcelanit;
- **Prodhim dhe tregtime**, materiale ndertimi, lëndë të parë inertesh për ndertim, si për përdorim & tregtim, brenda territorit të shqipërisë, ashtu edhe jashtë vendit;
- **Blerje dhe tregtim**, automjete të markave dhe tonazheve të ndryshme, si vetura për transporte personash, autobuza për transporte udhëtarësh, për linja të brendshme, turizme e agroturizem dhe linja ndërkombëtare; për transporte mallrash, karburante, vajra & lubrifikante si brenda vendit edhe jashtë shtetit sipas kontratave të lidhura për këto qëllim.
- **Blerje dhe tregtim:**
- pajisje elektroshtepiake dhe higjieno-sanitare.
- Mjete dhe pajisje elektronike, kompjutera, fotokopje, etj.
- Bojera karbonesh, me baze ujore e kolorike të llojeve të ndryshme.

Per kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mesipërme, për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këto leje nga organi kompetent.

Erlebe

Nriston

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **10 000 leke** dhe eshte i perbere nga **2 kuota**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në dy kuota me vlerë, qe perbejne 100% te kapitalit te shoqerise, qe zotërohet nga te dy Ortaket, i ndare ne dy kuota, si me poshte :

EROLD BALLA, zoteruesi i 1 kuote, qe perben 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, me vlere te pergjitheshme 5000 leke.

NENSI RISTANI, zoteruesi i 1 kuote, qe perben 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, me vlere te pergjitheshme 5000 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Erlepa

N.Ristani

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për cheshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë është **Z. EROLD BALLA**, i cili do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë **5 vjetore me të drejtë ripërteritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblesë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,


Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar



Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16


Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe. Ky akt pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare **ne krijim e siper**, neshkruhet rregullisht prej nesh ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen tone origjinale.

Ngarkohet **EROLD BALLA**, per depozitim te ketyre akteve prane QKB.

ORTAKET THEMELUES

EROLD BALLA

Erold Balla


NENSI RISTANI

Nensi Ristani
